

Universiteti Barleti
Nr. prot. 1814 Tiranë 10.11.2023

Intermedica Center Sh.p.k
Nr. prot. 166 Tiranë: 09.11.2023

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
NDËRMJET:**

UNIVERSITETIT BARLETI

(Universitet Aplikativ dhe Sipërmarrës)

dhe

Subjekti

INTERMEDICA CENTER SH.P.K


Duke mbajtur parasysh se:

- *Institucionet e Arsimit të Lartë janë qendra kryesore të kërkimit shkencor kombëtar dhe është detyrë e tyre të përpunojnë e të përçojnë në mënyrë krijuese njohuritë shkencore;*
- *është në interes të IAL-ve të vendosin një raport të qëndrueshëm bashkëpunimi e shkëmbimi akademik, shkencor e kulturor;*
- *palët synojnë shkëmbimin e dijeve dhe rinovimin e njohurive të përbashkëta përmes leksioneve të hapura, seminareve, trajnimit në laborator dhe praktikave;*
- *palët synojnë ngritjen dhe zhvillimin e një sistemi të përbashkët kooperimi që do të promovojë specialistë të mirëfilltë.*

Palët bien dakord të bashkëpunojnë, për krijimin e një bashkëpunimi afatgjatë në kuadër të programeve të Departamentit të Shkencave Mjekësore Teknikë si pjesë të Fakultetit të Shkencave Mjekësore.

**Neni 1
Qëllimi dhe Objekti**

1. Kjo marrëveshje ka si qëllim rregullimin e bashkëpunimit mes institucioneve nënshkruuese, duke përcaktuar detyrimet e përgjithshme të palëve, drejt realizimit në një moment të dytë të marrëveshjeve specifike lidhur me fushat e bashkëpunimit e shkëmbimit të listuara në pikën 2 të këtij





neni. Në marrëveshjet specifike do të detajohet lloji i aktiviteteve të përbashkët, si dhe çdo detyrim finansiar midis palëve.

2. Objekti i kësaj marrëveshje është bashkëpunimi dhe mbështetja reciproke midis palëve në fushat si vijon:

- a. **Fuqizimi i Sektorit dhe Profesionistëve** ne përputhje me Standartet, Normat dhe Direktivat e BE si dhe përmirësimi ligjore për mbështetjen dhe mirëfunkcionimin e profesionit:
 - i. Përafrimi me Nismat dhe Iniciativat Europiane si dhe mbështetje për draftime ligjesh dhe lobim përfuqizimin e sektorit dhe profesionit.
 - ii. Koalicioni, Rrjetëzime dhe Partneritet si dhe Aderimi ne Rrjete Profesionale Europiane përmes Platformave dhe Forumeve mbi tema specifike te Sektorit.
 - iii. Promovimi i dyanshëm i Universitetit dhe Subjektit dhe mbështetje përfunksionet e objektivat specifike te secilit.
- b. **Zhvillimi i kapitalit njerëzor** përmes edukimit dhe aftësimit drejt kërkesave te tregut te punës përfërshi diplomuarit e rinj si dhe zhvillimin e kualifikimin e vazduar për profesionistet e sektorit.
 - i. Shkëmbim të stafit akademik dhe/ose specialistëve;
 - ii. Praktika mësimore dhe punësim të të diplomuarëve;
 - iii. Përdorimin e ambienteve respektivisht përfaktika, laboratore, konferenca etj
 - iv. Orientim përf Zhvillimin e karrierës dhe aftësim për profesionet e së ardhmes
 - v. Kurse trajnimi te vazduar dhe shkolla verore, certifikata e diploma te përbashkëta
- c. **Kërkimin Shkencor të Aplikuar dhe Novacionin e hapur** si dhe evenete e aktivitete përf te promovuar dhe shkëmbyer eksperiencat.
 - i. Organizimi i seminareve, konferencave, publikimeve dhe aktivitete të ndryshme shkencore.
 - ii. Konsulenca, Studime, Analiza dhe Botime,
 - iii. Komercializim përf idetë, produktet e shërbimet si dhe sipërmarrjet e iniciativat e reja.
- d. **Ngritjen dhe realizimin e projekteve dhe programeve nga fonde dhe donator te ndryshëm.**
 - i. Menaxhimi i Ciklit te Projekteve
 - ii. Përafrimi me Nismat e Iniciativat Europiane
 - iii. Praktika te reja dhe zgjidhje novatore ne baze te eksperiencës.

Neni 2

Kohëzgjatja e marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga përfaqësuesit e të dyja palëve dhe mbeten në fuqi për 1 (nje) vit nga data e nënshkrimit.
2. Me përfundimin e afatit, nëse asnjëra nga palët nuk shpreh vullnetin përf t'i dhënë fund, kjo marrëveshje do të konsiderohet e rrinovuar.

Neni 3
Informacion mbi palët

1. *Universiteti BARLETI* (në vijim Barleti) është institucion jo publik i arsimit të lartë, i cili ndër vite ka promovuar një nivel të lartë edukimi, duke synuar të zhvillojë prirjet e çdo studenti, me objektivin e krijimit të ekspertëve më të mirë, të aftë për të konkurruar në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar. Misioni i Universitetit është krijimi i një institucionit akademik elitar, bazuar në praktikat e vlerat më të mira ndërkombëtare, më programe shumë-disiplinore të vënë në jetë nga akademikët më të mirë shqiptarë.

2. Intermedica Center Sh.p.k u themelua në qershor të vitit 1996, falë dëshirës së fortë të Dr. Vasil Llajo për të sjellë një risi në panoramën mjekësore private. Intermedica është laboratori i parë privat si pionier i këtij aktiviteti dhe ka si objektiv kryesor ofrimin e praktikave më të avancuara ndërkombëtare në shërbim të pacientëve në Shqipëri. Aktualisht numëron 25 Filiale në Tiranë edhe me shtrirje ne qytetet kryesore te Shqipërise.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e partnerëve

1. *Universiteti Barleti:*

- Angazhohet në ofrimin e ambienteve për trajnime, workshope, forume, konferenca kombëtare, konsultime, fushata informimi, promovimi e ndërgjegjësimi etj;
- Angazhohet, në bashkëpunim me partnerin, për të ndërmarrë të gjitha nismat dhe hapat e nevojshëm organizativë për programimin e çdo aktiviteti e nisme të rënë dakord midis palëve në zbatim të objektit të kësaj marrëveshje.
- Angazhohet të mbështesë dhe t'i ofrojnë kontribut Intermedica Center Shpk, me kërkesën e tij, duke vënë në dispozicion specialistët e tij më të mirë;
- Shpreh vullnetin për të bashkëpunuar e sjellë rezultate pozitive në drejtim të partneritetit dhe realizimit të objektivave të Universitetit për përbushjen e misionit dhe vizionit në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe standardet më të mira në nivel europian;
- Personi i kontaktit do të jetë: Z/Znj. _____.

2. *Intermedica Center Sh.p.k:*

- Angazhohet në ofrimin e ambienteve të nevojshme për realizimin e laboratorëve, praktikave dhe specializimin e studentëve të Barletit;

- b. Angazhohet në ofrimin e mundësive të punësimit për studentët më të mirë në përputhje me strategjitë e brendshme të zhvillimit të subjektit;
 - c. Angazhohet në bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen në trajnime, workshope, forume, konferenca kombëtare, konsultime, fushata informimi, promovimi e ndërgjegjësimi etj;
 - d. Angazhohet, në bashkëpunim me partnerin, për të ndërmarrë të gjitha nismat dhe hapat e nevojshëm organizativë për programimin e çdo aktiviteti e nisme të rënë dakord midis palëve në zbatim të objektit të kësaj marrëveshje;
 - e. Angazhohet të mbështesë dhe t'i ofrojnë kontribut Barleti, me kërkesën e tij, duke vënë në dispozicion stafin e nevojshëm;
 - f. Personi i kontaktit do të jetë: Z. Thoma Vasili.
3. *Palët bashkërisht bien dakord si vijon:*
- a. të organizojnë takime periodike, të paktën 1 (një) herë në vit;
 - b. të bashkëpunojnë në çdo fushë tjeter të pa listuar më sipër, brenda objektit të tyre dhe për të cilët palët kanë kapacitetet e përshtatshme profesionale.

Neni 5

Dispozita të fundit

1. Kjo marrëveshje mund të ndryshohet në bazë të konsensusit ndërmjet palëve nënshkruese, të shprehur në një dokument të shkruar.
2. Mosrespektimi i detyrimeve që rrjedhin nga kjo marrëveshje bashkëpunimi, nga njëri prej partnerëve, sjell si pasojë prishjen e saj. Vullneti për mbarimin e marrëveshjes para afatit, komunikohet me shkrim nga partneri, duke argumentuar arsyet e këtij veprimi.
3. Kjo marrëveshje përban 4 (katër) faqe dhe hartohet në gjuhën shqipen në 4 (katër) kopje origjinale me të njëjtën vlerë ndër të cilat 2 (dy) i mban Barleti dhe 2 (dy) Intermedica Center Sh.p.k. Duke marrë parasysh përcaktimet e mësipërme palët ranë dakord:



Intermedica Center Sh.p.k
Administrator

